

UDHËZIM
Nr. 80, datë 6.3.2020

**PËR KUSHTET E ZBATIMIT TË URDHRIT PËR EVAKUIMIN E NDËRTESAVE
QË JANË OBJEKT I MASËS SË SEKUESTROS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 20, të aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”;

Me qëllim përcaktimin e kushteve të zbatimit të urdhrin për evakuimin e ndërtesave që janë objekt i masës së sekuestros, sipas aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020,

UDHËZOJ:

I. PËRKUFIZIME

Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Masë e sekuestros” është masa parandaluese e vendosur me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në zbatim të nenit 19 të aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020.

2. “Operacioni Forca e Ligjit (OFL)” është strukturë e veçantë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

3. “Ndërtesë” janë pasuritë e paluajtshme për të cilat është vendosur masa e sekuestros, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndërtuara për të zhvilluar aktivitete të ndryshme.

4. “Evakuim” është largimi i njerëzve dhe i sendeve nga ndërtesat objekt i masës së sekuestros.

II. KATEGORIA E NDËRTESAVE, OBJEKT I MASËS SË SEKUESTROS, QË DUHET TË EVAKUOHEN

1. Ndërtesat ndaj të cilave zbatohet procedura e evakuimit, sipas këtij udhëzimi, janë ndërtesat ndaj të cilave është vendosur masa e sekuestros nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

2. Kategoritë e ndërtesave që duhet t’i nënshtrohen evakuimit janë pasuritë e paluajtshme të cilat përdoren për:

- a) veprimtari prodhimi, magazinimi dhe/ose tregtare;
- b) veprimtari në fushën e hotelarisë, bar, restorante;
- c) në fushën e arsimit, kulturës, sportit;
- d) si dhe çdo objekt tjetër i mbyllur, i konstruktuar e i ndërtuar si ndërtesë me beton, gurë, tulla, dru ose llamarinë metalike, ku mund të zhvillohen aktivitete të ndryshme.

3. Përfshihen nga zbatimi i procedurave të evakuimit, ndërtesat të cilat rezultojnë të jenë të regjistruara për funksion banimi dhe aktualisht në to jetojnë persona, të cilët, sipas informacionit të marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nuk kanë mundësi tjetër strehimi.

III. KUSHTET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E URDHRIT TË EVAKUIMIT TË NDËRTESAVE

1. Urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për evakuimin e ndërtesave që janë objekt i masës së sekuestros, zbatohet nëse plotësohen këto kushte:

a) Vërtetohet fakti se urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për sekuestrimin e ndërtesës i është komunikuar subjektit, sipas nenit 5 dhe pikës 3, të nenit 19, të aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020;

b) OFL-ja ka informacion se ndërtesa që është sekuestruar me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit është e zënë dhe nuk do të lirohet nga pronari apo përfaqësuesi i tij;

c) OFL-ja ka informacion se ndërtesa (përfshirë pasurinë brenda saj) do të tjetërsohet, dëmtohet apo do të shkatërrohet nga pronari apo persona të tjerë, me qëllim pengimin e marrjes në dorëzim të saj;

d) Vlerësohet nga OFL-ja se evakuimi i ndërtesës është e vetmja mënyrë për dorëzimin e ndërtesës pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

2. Për zbatimin e urdhrin të evakuimit duhet të ndiqen edhe rregullat e mëposhtme:

a) Procedura e evakuimit dhe e lirit të ndërtesës duhet të kryhet duke shmangur çdo ngjarje të mundshme me pasoja të rënda për jetën e punonjësve të policisë dhe të personave që do të largohen nga ndërtesa.

Në pamundësi të parandalimit të këtyre ngjarjeve, procedura e evakuimit duhet të planifikohet për t'u zhvilluar në një orë dhe/ose datë tjetër nën drejtimin e zëvendës drejtorit të OFL-së;

b) Procedura e evakuimit dhe e lirit duhet të zhvillohet vetëm gjatës ditës, në kushtet e ndriçimit natyror;

c) Në rastet kur për shkak të proceseve teknologjike evakuimi bëhet i pamundur përkohësisht ose në raste kur në objekt zhvillohen veprimtari që nuk mund të ndërpriten apo ndërprerja sjell pasoja/dëme ekonomike, Policia e Shtetit duhet të marrë masat përkatëse për të vijuar proceset e punës ose të përcaktojë një afat deri në mbylljen pa pasoja të aktivitetit;

d) Në të gjitha rastet kur punonjësit e policisë që zbatojnë urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, sipas kushteve të parashikuara në këtë udhëzim, hasin në kundërshtime nga personat që do të evakohen, plotësojnë procesverbal për kundërshtim të punonjësit të policisë dhe zbatimin e urdhrin, sipas dispozitave të Kodit Penal;

e) Në rast se në ndërtesën, objekt i masës së sekuestros, ndodhen fëmijë, persona me paaftësi mendore/fizike, gra shtatzëna apo persona në gjendje jo të mirë shëndetësore, zbatimi i urdhrin të evakuimit shtyhet dhe në çdo rast zbatohet pasi të jenë marrë masat paraprake të largimit vullnetar apo me asistencë mjekësore/sociale nga ana e institucioneve përgjegjëse të pushtetit vendor.

IV. PROCEDURA E EVAKUIMIT DHE E LIRIMIT TË NDËRTESAVE, OBJEKT I MASËS SË SEKUESTROS

Për realizimin e procedurës së evakuimit ndiqen procedurat e mëposhtme:

1. FAZA PËRGATITTORE:

a) Të përgatitet plani i operacionit për kryerjen e evakuimit nga ndërtesa e sekuestruar;

b) Për efektet dhe ndikimin që mund të sjellë evakuimi i personave, punonjësit e policisë, para se të kryejnë operacionin, duhet të marrin udhëzimet përkatëse nga zëvendës drejtori i OFL-së;

c) Para fillimit të operacionit, oficeri përgjegjës i operacionit, kontrollon nëse dokumentacioni i nevojshëm është i plotë dhe nëse janë të gatshme forcat dhe mjetet e shërbimit ndihmës;

d) Caktohet oficeri komunikues me pronarët apo përfaqësuesit të tij, i cili verifikon nëse kanë marrë dijeni për masën e sekuestros ndaj ndërtesës, si dhe i komunikon afatin për dorëzimin e objektit;

e) Nëse sipas informacioneve që ka Policia e Shtetit, pronarët apo përfaqësuesit e tij mund të tjetërsojnë, dëmtojnë apo largojnë nga ndërtesa sende e mallra që janë objekt i sekuestrimit së bashku me ndërtesën, OFL-ja merr masa për ruajtjen e ndërtesës në bashkëpunim me strukturat vendore të policisë, deri sa të kryhet operacioni.

2. FAZA OPERACIONALE:

a) Pas kalimit të afatit për dorëzimin vullnetar të ndërtesës, OFL-ja përcakton ditën dhe orën e zhvillimit të operacionit të evakuimit;

b) Operacioni i evakuimit, që nga momenti i fillimit e deri në përfundim, duhet të bëhet me regjistrim audiovizual, që do të administrohet si provë për mënyrën e kryerjes së procedurës së evakuimit;

c) Gjatë operacionit, askush nuk mund të kryejë veprime të paplanifikuara ose jashtë urdhrin të drejtuesit të operacionit;

d) Operacioni do të kryhet në qetësi dhe me masa të përshkallëzuara, si dhe në komunikim të vazhdueshëm në radio me drejtuesin e operacionit;

e) Përdorimi i forcës bëhet me urdhër të drejtuesit të operacionit, vetëm kur kjo është nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura. Urdhri për përdorimin e forcës duhet të përcaktojë se ndaj kujt do të përdoret forca;

f) Drejtuesi i operacionit cakton oficerin që do të përgatitë dokumentacionin në rastet e kundërshtimit të zbatimit të urdhrave të policisë dhe oficerin që do të plotësojë procesverbalin e sekuestrimit të ndërtesës dhe sendeve që gjenden në të;

g) Drejtuesi i operacionit mund të ndërpresë përkohësisht operacionin e evakuimit, kur konstaton se operacioni nuk mund të vazhdojë, për shkak të kundërshtimit të dhunshëm apo vazhdimi i tij mund të sjellë pasoja dhe për këtë komunikon menjëherë me eprorët;

h) Pas përfundimit të operacionit, drejtuesi apo personi i ngarkuar prej tij merr masa për ruajtjen, për mbylljen e për dhënien në administrim të ndërtesës që është sekuestruar;

j) Dokumentacioni që administrohet për sekuestrimin e ndërtesës hartohet në tri kopje, nga të cilat një i dorëzohet pronarit (subjekt i aktit normativ) ose përfaqësuesit të tij, një Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe një kopje administrohet nga OFL-ja.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet drejtori i Operacionit Forca e Ligjit për marrjen e masave për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj